


Xhamia

sipas

Imam Khomeinit

Tiranë, 2018

Titulli: **Xhamia sipas Imam Khomeinit**

E përktheu: **Vullnet Merja**

Recensues: **Sabrie Feza**

E redaktoi: **Jerida Kulla**

E korrektoi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp & Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

بسم الله الرحمن الرحيم

PARATHËNIE

"Mbajeni revolucionin gjallë nëpërmjet xhamive. Ato janë kështjellat e fortifikuara, që e mbrojnë Islamin."

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)*

Xhamia është një litar që mban të lidhur qiellin me tokën. Teksa i sheh ato kupola dhe ato minare të larta, të drejtuara nga qielli, të duken si fytyra të rrumbullakosura dhe duar që zgjaten në drejtim të qiellit.

Xhamia është përfaqësuese e pastërtisë absolute, pasi në të nuk gjendet asnjë lloj papastërtie, as fizike, as morale. Ajo është një zonë rreptësisht e ndaluar për djajtë. Ajo është një zonë, ku epshet shtazarake nuk kanë vend. Duke qenë e tillë, ajo u shndërrua në burimin e pastërtisë, të besimit, të sinqeritetit dhe të kthjelltësisë.

Nuk ka furtunë, që ta shembë gardhin e saj dhe nuk ka dallgë, që mund të mbysë udhëtarët e saj. Xhamia është

një shkollë e madhe, të cilën Allahu i Madhëruar e ka cilësuar Shtëpinë e Tij.

Të gjithë duhet të ngremë disa pyetje: A jemi ne vërtet nxënës të asaj shkolle?! A jemi ne prej atyre, që Allahu i Madhëruar i ka shënuar dhe i ka regjistruar si frekuentues të xhamisë?! A e gjetëm qetësinë te xhamia dhe a është zbukuruar më shumë xhamia prej pranisë sonë?!

Le të përpiqemi të meditojmë sa të mundemi, gjatë kohës kur shfletojmë këto faqe modeste, që flasin rreth xhamisë. Kjo është një mënyrë e përshtatshme për të kuptuar rolin e saj të madh dhe detyrimet që kemi karshi saj.

Qendra për botime dhe përkthime "Nun"

KAPITULLI I PARË

POZITA E XHAMISË

Xhamia është boshti i lëvizjes islame

Gjatë kohës kur Profeti i nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* emigroi nga Meka për në Medine dhe nisi të vendosë piketat e para të fizionomisë së shoqërisë myslimane, hapi i parë që ai ndërmori, ishte ndërtimi i xhamisë në Medine. Ndërtimi i xhamisë në Medine ishte, në një farë mënyre, vendosja e gurthemelit të kësaj shoqërie. Që prej atij momenti të bekuar, xhamia u shndërrua në boshtin kryesor të lëvizjes islame. Ky është një fakt, që nuk lidhet thjesht me një teori të pranuar në mesin e myslimanëve, por një fakt të cilin e përforcon argumenti kur'anor dhe profetik, pasi gjen një mbështetje të plotë në orientimin e përgjithshëm të frymës së Zbulesës Hyjnore. Ky është një "fakt kokëfortë", i cili

mbështetet te të gjitha periudhat e historisë islame. Këtë do ta konstatojmë lehtësisht, kur të lexojmë faqet e këtij libri modest.

Transmetime të shumta vijnë për t'i dhënë një rëndësi të veçantë rolit qendror të xhamisë në lëvizjen islame.

Lidhur me këtë aspekt, transmetohet prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "Nuk ka namaz për fqinjin e xhamisë, përveçse në xhami, për sa kohë nuk është i zënë me çështje madhore dhe nuk është i sëmurë."[1]

Ky është një transmetim, ku duket qartë dhe vihet re dukshëm rëndësia e faljes së namazeve të detyrueshme në xhami. Në këtë thënie të prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* duket qartë se fqinji i xhamisë ftohet që ta falë namazin e obligueshëm në xhami, për sa kohë nuk është i justifikuar me sëmundje apo me çdo lloj justifikimi tjetër fetar.

[1] "Uesailush Shija", El Hirrul Amilij, vëll. 53, f. 195, hadithi 5.

Cili konsiderohet fqinj i xhamisë?!

Dikush mund të përfytyrojë dhe mund të mendojë se fqinj me xhaminë konsiderohet ai që e ka shtëpinë e tij ngjitur me xhaminë.

Prej transmetimeve të ndryshme kuptojmë se kuptimi i kësaj fjalie është shumë më i gjerë se kaq. Pra, ka kuptim shumë më të zgjeruar se kuptimi sipërfaqësor i saj. Disa prej dijetarëve dhe komentuesve të këtyre transmetimeve janë të mendimit se fqinj i xhamisë konsiderohet edhe ai që e ka shtëpinë dyzet shtëpi larg xhamisë.

Në një transmetim që na vjen prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, citohet: "Hurmeti i xhamisë (gjërat e ndaluara për t'u kryer në xhami) është dyzet hapa, ndërsa fqinj të xhamisë janë ata që banojnë deri në dyzet shtëpi në të katra drejtimet e saj."[2]

Disa komentues dhe dijetarë të tjerë janë të mendimit se fqinj të xhamisë konsiderohen të gjithë ata që e dëgjojnë ezanin. Transmetohet prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "Nuk ka namaz për fqinjin e xhamisë (nuk konsiderohet i plotë

[2] "Uesailush Shija", vëll. 3, f. 478.

namazi) përveçse në xhami, përveç rasteve, kur e ka një justifikim fetar, ose rasteve kur është i sëmurë."

Ata që e shoqëronin thanë: "O prijësi i besimtarëve! Cila është ajo kategori njerëzish, që konsiderohet prej fqinjëve të xhamisë?!"

Prijësi i besimtarëve *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* tha: "Ata që e dëgjojnë thirrjen (ezanin)."[3]

Kështu pra, në rast se namazet e obliguara janë pesë namaze në ditë, do të thotë që myslimani komshi i xhamisë është i detyruar të shkojë po aq herë në ditë në xhami. Kjo prani e vazhdueshme i jep xhamisë një rol qendror në jetën e tij.

Në kohën kur Imam Khomeini *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* e transferoi shoqërinë iraniane dhe emigroi bashkë me të, prej epokës së diktaturës, të tiranisë dhe të mbretërisë, kur e transferoi shoqërinë iraniane prej epokës së faraonizmit dhe të shtypjes, për në epokën e qeverisjes me ligjin e Zotit, për në epokën e artë të Teuhidit (Njehsimit), u kthye për të rivendosur edhe njëherë nga e para gurthemelin e besimit. U kthye për të rikthyer edhe njëherë rolin e rëndësishëm të xhamisë në jetën e myslimanëve, në jetën e shoqërisë.

[3] "Mustedrekul Uesail", vëll. 3, f. 356.

Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Përpiquni dhe bëni të pamundurën, që të rikthehet roli i xhamive, ashtu siç ka qenë në periudhën e parë të Islamit. Myslimanët duhet të jenë të vetëdijshëm, gjithashtu, se nuk ekziston në Islam asnjë teori e asnjë orientim, që i fton njerëzit të veçohen prej pjesës tjetër të njerëzve apo të vetizolohen."[4]

Në një tjetër fjalim, të mbajtur prej Imamit të nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, flitet sërish rreth domosdoshmërisë së kthimit të rolit të xhamisë, ashtu siç ka qenë në periudhat e para të Islamit. Midis të tjerave ai thotë: "Në periudhat e para të Islamit dhe jo vetëm, xhamia ka pasur një rol qendror dhe strategjik në pikënisjen e çdo lloj lëvizjeje islame. Pikënisja e çdo lloj përpjekjeje dhe nisme mediatike të myslimanëve ka qenë pikërisht xhamia. Xhamia ka qenë, gjithashtu, pikënisja, nga ku ushtritë myslimane kanë vërshuar për t'u përballur me armiqtë e Islamit, për t'u përballur me femohuesit dhe për t'i ftuar ata që të bëhen pjesë e udhëzimit të Islamit. Pra, mund të thuhet, me plot gojën, se xhamia ka qenë gjatë gjithë historisë, veçanërisht në periudhat e para të Islamit, pikënisja dhe epiqendra e çdo lloj lëvizjeje islame, cilado qoftë natyra apo karakteri i saj."[5]

[4] "El Kelimatul Kisar", f. 64.
[5] "Menhexhijetuth Theureh", f. 478.

Nisur nga sa u citua më sipër, mund të themi se xhamia nuk është e rëndësishme dhe nuk është pikë orientimi për jetën shpirtërore të besimtarit. Ajo është pikënisja dhe vendi prej nga ku lind dhe nis rrugëtimin e saj qeveria islame.

Simbolika e xhamisë

Mënyra sesi Imami Khomeini *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* e paraqet xhaminë nuk është e lidhur me trajtimin e saj si një ndërtesë e ftohtë, e vizituar prej njerëzve disa herë në ditë. Ai ka një botëkuptim shumë më të gjerë, lidhur me rolin e saj në shoqëri. Në mendimin dhe në gjykimin e Imamit të nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* xhamia është një pikënisje e fuqishme, prej të cilës frymëzohen të gjitha etapat e formimit të njeriut dhe të ekzistencës së tij. Ekzistenca e xhamisë është e lidhur me simbolikën e orientimit të qenies dhe të rrugëtimit të saj të pandërprerë në drejtim të Allahut të Madhëruar dhe në drejtim të fesë së Tij.

Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* e vë theksin mbi tre etapa apo stade shumë të rëndësishme të këtij formësimi apo të kësaj zanafille:

a. Zanafilla natyrore dhe pozita sipërfaqësore, e lidhur me këtë botë, është e lidhur me vendin e ndërtimit (të xhamisë), që është natyra.

Lidhur me këtë, Profeti i nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* thotë: "Më është dhënë prej Zotit një privilegj i veçantë. Zoti e ka

bërë tokën për mua dhe për pasuesit e mi të pastër edhe vendfalje."[6]

Në një moment të dytë, Imami i nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Të gjithë ata që kanë nisur rrugëtimin e tyre për te drita e besimit, duhet ta ndiejnë thellësisht faktin se e gjithë bota dhe e gjithë natyra është vend i pastër, ku ata mund ta adhurojnë Allahun e Madhëruar.

Në fakt, arsyeja përse Zoti na ka vendosur mbi këtë tokë dhe mbi këtë natyrë, është që ne ta adhurojmë Atë. Lidhur me këtë çështje Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

"وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ"

"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë mua."[7]

Duke qenë se e gjithë sipërfaqja e tokës është e pastër dhe është e mundur për t'u falur e për t'u adhuruar Zoti, kjo do të thotë se ekzistenca jonë mbi kurrizin e saj është një formë e caktuar adhurimi.

[6] "Al Adab El Ma'aneuijeh Lis'salat" - "Normat morale të namazit", f. 185.

[7] "Al Adab El Ma'aneuijeh Lis'salat" - "Normat morale të namazit", f. 185.

Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Kjo e bën të detyrueshme për çdo besimtar dhe besimtare, i cili/e cila jetën e tij e jeton dhe e ushtron mbi tokën e pastër, të dhuruar prej Zotit, të mos përmendë e të mos adhurojë askënd tjetër përpos Tij. Është detyrë e të gjithë njerëzve, sikurse është prej normave të edukatës me këtë vendfalje, që të mos shkëputesh prej adhurimit, përveç rasteve dhe nevojave të veçanta. Pasi të ketë konsumuar rastet dhe nevojat e veçanta, kthehet sërish aty dhe nuk adhuron askënd tjetër përveç Allahut të Madhëruar. Nuk e lidh zemrën me askënd tjetër përveç të Lartësuarit Allah. Të gjitha këto rregulla dhe dispozita duhet të respektohen, sepse nuk është e hijshme, që të ndodhë e kundërta në praninë e Allahut dhe te dera e Madhështisë së Tij."[8]

b. Pozita e fuqive të dukshme dhe të padukshme, e cila përfaqëson ushtarët e dukshëm dhe të padukshëm të shpirtit (nefsit) e ka vendin në tokë dhe në natyrë. Ato janë ndërtesa (toka) dhe trupi i njeriut.[9]

Në këtë mënyrë, njeriu e shndërron qenien në faltore, në të cilën është e ndaluar të hyjnë djajtë, sikurse është e ndaluar që në të të bien në sexhde ushtarët e (nefsit/shpirtit/egos).

[8] "Mim Nun", f. 185.
[9] "Mim Nun", f. 186.

Imami i nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Është prej edukatës dhe mirësjelljes së adhuruesit që gjendet në këtë pozitë, që t'ia bëjë me dije thellësive të zemrës së tij, se kjo tokë dhe kjo natyrë është vendi në të cilin i bëhet sexhde (përulje) Zotit, ndërsa vendi ku balli ulet në sexhde është i ushtarëve të mëshirës.[10] Atij vendi i përshtaten të gjitha dispozitat e xhamisë dhe të vendfaljes. Për këtë arsye, nuk lejohet që ai vend të bëhet pis me pisllëkun e veprave të ulëta djallëzore dhe me pisllëkun e veprave të ulëta dhe të pista të egos.

Lidhur me këtë pjesë, Imam Khomeini *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Mos ta bëjë pis atë, nëpërmjet punëve të pista të Iblisit, sepse kjo është mënyra e vetme, që drita e Zotit të mbulojë natyrën mbi të cilën ka vendosur njerëzit e tij. Kjo është e vetmja mënyrë, që ajo natyrë të dalë dhe të çlirohet prej errësirës që ndikon largimi prej sipërfaqeve të Afrimitetit. Duke e mbrojtur veten (shpirtin/nefsin) prej papastërtive, njeriu e shndërron veten e tij në një faltore dhe, sa herë qëndron brenda vetes së pastër, e konsideron atë në xhami. Sillet me veten dhe me brendësinë e qenies sikur të jetë në xhami. I trajton fuqitë e tij si transportuese të qenies për te Krijuesi i saj. Detyra e adhuruesit, në këtë rast, është e dyfishtë, pasi pastrimi i xhamisë, gjithashtu, është prej detyrave të tij. Nga ana tjetër, ashtu siç u përmend edhe më sipër, mbajtja

[10] "Mim Nun", f. 186.

pastër e qenies së tij është pjesë e pandarë e mbajtjes pastër së vendfaljes së xhamisë.[11]

c. Zanafilla e fshehtë e adhuruesit, vendi i së cilës është trupi i padukshëm dhe i amshueshëm i qenies së formuar prej vetvetes.[12]

Kjo zanafillë është edhe origjina e të gjitha zanafillave. Ajo ka ndikimet e saj të mëdha te të gjitha llojet e tjera të tyre.

Imam Khomeini *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* hedh dritë mbi këtë aspekt dhe thotë: "Është prej edukatës së adhuruesit, që të ndikojë te qenia e tij, në mënyrë që ajo të jetë e aftë të dallojë se ndryshimi ndërmjet këtyre dy pozitave është shumë i madh. T'i mësojë asaj, gjithashtu, se përkujdesja për këtë pozitë është prej detyrave të sjelljes, sepse zemra është prijëse e vendadhurimeve në këtë aspekt. Nëse prishet zemra, prishet i gjithë trupi. Sikurse, nëse prishen dijetarët, prishet e gjithë bota."[13]

Kjo pozitë ndryshon nga dy pozitat e tjera, sepse urdhëresa e ardhur për domosdoshmërinë e pastrimit të trupit nuk është e lidhur ngushtësisht me domosdoshmërinë e largimit të papastërtive fizike dhe

[11] "Al Adab El Ma'aneuijeh Lis'salat" - "Normat morale të namazit", f. 168.
[12] "Mim Nun", f. 186.
[13] "Mim Nun", f. 186-187.

trajtimin e saj në mënyrë të ngjashme me xhaminë. Detyra e tij është ndërtimi i kësaj xhamie, që në themel. Kjo ndryshon nga pozitat e tjera, pasi ndërtimi i kësaj xhamie shpirtërorë, në brendësi të qenies së tij, është detyrë dhe detyrim i besimtarit. Vetëm pasi të ketë ndërtuar këtë "ndërtesë", mund të nisë adhurimin dhe rrugëtimin e tij kah Allahu.

Lidhur me këtë pjesë, Imami i nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Detyrimet e adhuruesit në këtë pozitë janë më të mëdha dhe më të shumta se detyrimet e tij te dy pozitat e tjera, pasi ai është obliguar që ta ndërtojë xhaminë brenda qenies së tij. Sigurisht, ekziston mundësia që kjo xhami (Mos e dhëntë Zoti!) të jetë një xhami përçarëse (dirar) ndërmjet myslimanëve dhe besimtarëve. Nuk lejohet kurrsesi, që në këtë xhami të padukshme (shpirtërore), të ndërtuar thellë qenies, që është në shërbim të Hyjnores, të preket prej papastërtive dhe pisllëqeve të ndryshme. Adhuruesi duhet të përpiqet maksimalisht që ta transferojë veten prej qëndrimit në xhami për te hapësirat e shenjta të Afrimitetit të të zotit të vërtetë të xhamisë. Nëse arrin të pastrohet dhe të çlirohet prej prangave të vetes, ai shndërrohet në vetvete në një vendzbritje të së vërtetës së Allahut, madje mund të themi se shndërrohet në një xhami të vërtetë. Ajo qenie shndërrohet në një xhami, në të cilën Allahu i Lartësuar e lavdëron veten e Tij, nëpërmjet reflektimit të Emrave dhe të Cilësive të Tij. Kjo lloj

shfaqjeje dhe ky lloj reflektimi i Tij, në tërësinë e Tij, është mënyra nëpërmjet të cilës Zoti e kryen lartësimin e vetvetes, duke thënë: "I Lavdëruar dhe i Shenjtë, është Zoti i engjëjve dhe i shpirtit."[14]

Pas të gjitha këtyre shpjegimeve dhe sqarimeve, duket qartë se gurthemeli i shoqërisë islame dhe boshti i orientimit të qenies myslimane, si lëvizje islame e qenies, mund të përmblidhen shumë shkurt në një fjalë të vetme, që është "Xhamia".

[14] "Al Adab El Ma'aneuijeh Lis'salat" - "Normat morale të namazit", f. 187.

Ç'është Xhamia?

Xhamia është shtëpia e Allahut.

"وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا"

"Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut."[15]

Që diçka të jetë e Allahut të Madhëruar dhe t'i përkasë Atij, kjo do të thotë se kjo "diçka" është një e mirë absolute. Kjo "diçka" është përfaqësuese e boshtit të udhëzimit dhe të qetësisë së Allahut, që zbret në qiellin e kësaj bote të mbuluar prej reve të iluzionit dhe të hutisë. Që diçka të jetë e Allahut të Madhëruar dhe t'i përkasë Atij, do të thotë që kjo "diçka" të jetë burim prej të cilit njeriu përfton shumë dhe shuan etjen e tij të madhe në shkretëtirën e jetës. Kjo ndodh në ato raste kur "diçkaja" i përket Allahut të Madhëruar, por ne nuk kemi të bëjmë më thjesht me "diçka" që i përket Allahut, por kemi të bëjmë me shtëpinë e vetë Zotit, ashtu siç e gjejmë të përmendur në transmetime të ndryshme.

Transmetohet prej Imam Sadikut *(Paqja e Zoti mbi të!)*: "Frekuentoni sa të mundeni xhamitë, sepse ato janë

[15] "Sure "El Xhinn", ajeti 18

shtëpitë e Allahut në Tokë. Ata që i frekuentojnë ato, fizikisht të pastruar, Allahu i Madhëruar do t'i pastrojë prej gjynaheve dhe do të konsiderohen prej vizitorëve të tij. Faluni sa më shumë të mundeni dhe dërgoni sa më shumë salavat."[16]

[16] "Biharul Enuar", vëll. 77, f. 308.

Çfarë nënkuptohet me "Shtëpia e Allahut"?

Lidhur me këtë mund të themi se "Shtëpia e diçkaje" është vendi ku ajo diçka, më së shumti, vendodhet. Një shembull, lidhur me këtë, është "Shtëpia e parave të myslimanëve". Quhet e tillë, pasi aty është vendi ku mblidhen dhe vendosen paratë e mbledhura prej myslimanëve apo taksat e tyre dhe më pas shpërndahen për pjesën tjetër të njerëzve, sipas nevojës. Shtëpia e njeriut, është vendi që njeriu e përdor për të banuar (për të vendosur veten) dhe për të kryer brenda saj nevojat e tij të ndryshme. Nisur nga kjo, gjithçka dhe gjithkush ka shtëpinë e tij/e saj.

Shtëpia e Allahut, është vendi që shërben për të furnizuar qenien dhe jetën e saj me mirësitë, begatitë dhe shpërblimin e Allahut të Madhëruar. Ajo është vendi ku njeriu kërkon lidhjen e fortë me Allahun e Madhëruar dhe ndihmën e Tij. Paramendohet, gjithashtu, se xhamia është vendi, ku prania e Allahut të Madhëruar të jetë më e madhe, sikurse edhe gjendja emocionale dhe shpirtërore e besimtarit të jetë e tillë. Xhamia konsiderohet një vend, ku njeriu gjendet larg ndikimeve të angazhimeve dhe të punëve të përditshme, për rrjedhojë edhe përqendrimi i tij në adhurim është më i madh. Pyetja, që me të drejtë lind në

këtë rast, është: Çfarë do të përfitojmë prej pranisë sonë në xhami?!

Në "Shtëpinë e parave të myslimanëve" mund të gjejmë para. Në shtëpinë (depot) e armëve, mund të gjejmë armë. E pra, çfarë mund të përfitojmë ne konkretisht prej "Shtëpisë së Allahut"?!

Disa njerëz shkojnë në xhami thjesht për të kryer adhurimet.

Disa të tjerë shkojnë në xhami për të kërkuar faljen dhe mëshirën e Zotit. Disa të tjerë shkojnë dhe kërkojnë prej Allahut të Madhëruar që Ai t'u japë sukses në këtë botë.

Mos vallë, xhamia është thjesht për të kryer adhurimet dhe më pas për t'u larguar?! Mos vallë, është thjesht për të kërkuar faljen dhe Mëshirën e Zotit?! Apo mos është për të kërkuar suksesin në këtë botë?!

Po të kishte qenë qëllimi i xhamisë realizimi i njërit prej këtyre qëllimeve, apo i çfarëdolloj qëllimi tjetër në veçanti, atëherë xhamia do të mund ta merrte emrin prej njërit prej këtyre qëllimeve. Ajo mund të quhej, për shembull, "shtëpia e faljes", apo "shtëpia e mëshirës", apo "shtëpia e adhurimit". Vëmë re se ajo nuk ka marrë asnjërin prej këtyre emërtimeve, por është quajtur "Shtëpia

e Allahut". Pyetja që lind, është: Cila është veçoria e Emrit të Shenjtë "Allah"?

Veçoria e Emrit të Shenjtë të Allahut, në këtë rast, qëndron në faktin se prania e saj nuk është përfaqësuese e një cilësie prej cilësive të tij, duke lënë pa përmendur cilësitë e tjera. Ky Emër i Shenjtë është përmbledhja e të gjitha Emrave dhe Cilësive.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë

"فَأَيْنَمَا تُوَلُّواْ فَثَمَّ وَجْهُ اللّهِ"

"Ngado që të ktheheni, është Fytyra (ana) **e Allahut."**[17]

Bazuar mbi këtë ajet të nderuar, mund të themi se "Shtëpia e Allahut" është përfaqësuese dhe përfshirëse e të gjitha mirësive të përfshira te Emrat e Allahut të Madhëruar dhe te të gjitha Cilësitë e Tij. Ky Emër i madh është burimi i të mirave absolute, në të gjitha rrafshet dhe dimensionet. Allahu i Madhëruar na ka njoftuar rreth Vetes së Tij dhe ka thënë se të gjitha format nëpërmjet të cilave shfaqet e mira, burojnë vetëm prej Allahut të Madhëruar. Kështu, xhamia është Shtëpia dhe qendra e Tij më e rëndësishme.

[17] Sure "El Bekare", ajeti 115.

Këtë çështje, dashtë Allahu, do ta sqarojmë në mënyrë më të hollësishme gjatë kapitujve dhe faqeve në vijim.

Cilat janë detyrimet tona ndaj këtij vendi dhe ndaj kësaj mirësie të madhe?

KAPITULLI I DYTË

DETYRIMET TONA NDAJ XHAMISË

Ndërtimi i xhamisë

Xhamia është përfaqësuese e fytyrës së vërtetë të shoqërisë islame, sikurse është zemra e asaj shoqërie.

Nga këndvështrimi panoramik, xhamia është fytyra apo përfaqësuesja e tiparit kryesor të qyteteve dhe të vendbanimeve islame, pasi prania e atyre kubeve të rrumbullakosura dhe e atyre minareve që ngrihen lartësive të qiellit, tregojnë identitetin fetar të atyre vendbanimeve.

Njëra prej problematikave kryesore, me të cilat përballen sot shoqëritë islame, është pikërisht humbja e identiteteve të tyre, qoftë të atij arkitektonik, qoftë të atij kulturor. Shoqëritë myslimane të ditëve të sotme, e kanë humbur, fatkeqësisht, identitetin e tyre dhe përpiqen të

imitojnë të tjerët. Vetë ekzistenca e këtyre minareve dhe e këtyre kupolave është tregues i qartë i identitetit të një qyteti a vendbanimi. Përveç kësaj, prania e tyre është një tjetër simbolikë dhe tregues i rëndësishëm i orientimit të përgjithshëm të një shoqërie.

Ajo konsiderohet, gjithashtu, zemra e një shoqërie, sepse prej damarëve të saj furnizohet një shoqëri e tërë me njerëz të përkushtuar, të devotshëm, që e kanë frikë Zotin. Xhamia është organi i rëndësishëm, që ndihmon në pastrimin e gjakut të shoqërisë, sikurse e ndihmon atë të përmirësohet e të reformohet. Të gjithë jemi dëshmitarë dhe bashkë me ne edhe historia dëshmon se vendet e shthurura janë përmirësuar dhe ka ndryshuar gjendja e tyre, pasi janë ndërtuar në ato vende xhami. Ndërtimi i xhamive krijon mundësinë, që, në atë shoqëri, të përcillet një frymë dhe një shpirt pozitiviteti. Për këtë arsye, janë të shumta transmetimet që na ndihmojnë të kuptojmë se Islami jo vetëm e nxit ndërtimin e xhamive, por e ndihmon shumë atë nga ana fetare.

Transmetohet prej Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "Allahu i Madhëruar do të ndërtojë shtëpi në Xhenet për atë njeri që ndërton një xhami në tokë."

Ebu Ubejde tha: "Pranë meje kaloi Ebu Abdilahu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në një rrugë të Mekës. Kisha ndërtuar një xhami me gur dhe iu drejtova atij: "Për hatër

të Zotit (t'u bëfsha kurban) të më tregosh, a është kjo xhami prej xhamisë së përmendur në hadithin e mësipërm?!"

Ai më tha: "Po, e tillë është."[18]

Transmetohet, gjithashtu, prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*: "Çdonjëri prej jush, që ndërton një xhami, me qëllim që të përmendet e të kujtohet në të Allahu i Madhëruar, për të do të ndërtohet një shtëpi në Xhenet. Ndërsa ai që shpenzon paratë e tij për të blerë lirinë e një skllavi mysliman, do të shpëtojë prej zjarrit të Xhehenemit prej mirësisë së asaj vepre, si dhe çdo thinjë e dalë në kokën e një myslimani, gjatë kohës që ai përpiqet për të mirën e Islamit, do të jetë dritë për të në Ditën e Gjykimit."[19]

Nisur nga sa u përmend më sipër, vërejmë se Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* ka nxitur, gjithashtu, ndërtimin e xhamive: "Ndërtimi i xhamive është prej veprave të pëlqyeshme, të lavdëruara dhe të shpërblyera shumë prej Allahut të Madhëruar."

Transmetohet prej Profetit të Islamit *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*:

[18] "El Kafii, Esh Shejh El Kelinii", vëll. 3, f. 368.
[19] "Reudatul Uaidhine, f. 337.

"Secili prej atyre që do të ndërtojnë një xhami në tokë, Allahu do t'ia shpërblejë për çdo pëllëmbë ndërtim…."

Në një transmetim tjetër, thuhet: "Për çdo pashë ndërtim, do të shpërblehet me një sipërfaqe qyteti, që duhet dyzetmijë vjet për ta përshkuar. Ato sipërfaqe do të jenë prej floriri, prej argjendi, prej margaritarësh dhe prej perlash të çmuara."[20]

Për këtë arsye, shoqëritë tona duhet ta kultivojnë sa më shumë kulturën e ndërtimit të xhamive, deri sa kjo kulturë të shndërrohet në një formë sjelljeje, në një formë të të menduarit, si dhe të jetë shqetësimi më i madh që rëndon në zemrat e besimtarëve, në mënyrë që ata të shpenzojnë energjitë e tyre më të mëdha për përmbushjen e këtij qëllimi të shenjtë.

[20] "Tahrirul Uesi.leh", vëll. 1, f. 152.

Mos i braktisni xhamitë!

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Mos i braktisni xhamitë, sepse jeni të ngarkuar prej Allahut që t'i frekuentoni ato."[21]

Duke qenë se xhamia është njëkohësisht përfaqësuese e boshtit kryesor të orientimit të myslimanit dhe e besimit të tij, atëherë braktisja dhe heqja dorë prej saj do të thotë braktisje e bërthamës së orientimit të shoqërisë islame dhe një shthurje dhe destabilizim tërësor i saj. Në fakt, kjo është dhe njëra prej sëmundjeve më të rrezikshme, prej të cilës mund të goditet shoqëria islame.

Në disa raste, Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* është shprehur se vetë ekzistenca e Islamit është e lidhur me vazhdimësinë e pranisë së xhamive në shoqërinë islame.

Lidhur me këtë, Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Mbrojtja e xhamive është prej çështjeve themelore, mbi të cilat qëndron ekzistenca e Islamit, në ditët e sotme."[22]

[21] "Kelimatun Kisar", f. 64.
[22] "Kelimatun Kisar", f. 65.

Thelbi i përmbajtjes se fjalëve të Imam Khomeinit *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* është pjesë e të tjera transmetimeve që na kanë ardhur.

Transmetohet që Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* të ketë thënë: "Xhamitë i janë ankuar Allahut të Madhërishëm për komshinjtë e tyre, që i vështrojnë në largësi, por nuk i frekuentojnë. Nëpërmjet formave të Zbulesës Hyjnore, Allahu i Madhëruar u ka komunikuar atyre dhe u ka thënë: "Pasha Madhërinë Time, nuk kam për të pranuar asnjë namaz të tyre, nuk kanë për të gjetur drejtësi në mesin e njerëzve, nuk kanë për t'u përfshirë nga Mëshira Ime dhe as kanë për të qenë pranë Meje në Xhenet."[23]

Referuar hadithit të mësipërm, mospranimi i namazit dhe mospërfshirja në Mëshirën e të Gjithëmëshirshmit, janë dy të meta të mëdha dhe njëkohësisht shumë të rrezikshëm, që e bllokojnë në mënyrë të menjëhershme qëllimin përfundimtar të adhurimeve. Është shumë e rrezikshme, që vlera e besimtarit dhe tërësia e adhurimeve që ai kryen, sado të mëdha qofshin, të jenë të zhveshura prej fryteve të tyre në rrafshin strategjik dhe afatgjatë. Edhe pse kjo situatë mund të jetë e shoqëruar prej fryteve momentale dhe kalimtare, mund të përsërisim dhe të themi lehtësisht se në rrafshin

[23] "Ueasailush Shija", vëll. 3, f. 840.

strategjik dhe atë afatgjatë, kjo do të thotë humbje e shoqërisë islame dhe çmontim i plotë i të gjithë elementeve që e mbajnë në këmbë Islamin.

Në rast se njeriu nuk di ta vlerësojë një mirësi, me të cilën Allahu i Madhëruar e ka begatuar, ajo shndërrohet në një fatkeqësi.

Transmetohet prej Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "Tre janë ata që do t'i ankohen Allahut të Madhëruar: Xhamia e braktisur dhe e boshatisur prej besimtarëve, që nuk frekuentohet. Dijetari në mesin e injorantëve, si dhe një Kur'an i varur në mur, i mbuluar prej pluhurit, sepse nuk ka kush ta lexojë."[24]

I kërkojmë Allahut mbrojtje prej gjendjes në të cilën xhamitë ankohen prej nesh, sikurse i lutemi Atij, që të mos i sjellë xhamitë të dëshmojnë kundër nesh në Ditën e Gjykimit.

[24] "Mim Nun", f. 484.

Frekuentimi i xhamive

Popullim i xhamive, do të thotë frekuentimi i vazhdueshëm i tyre, duke u dhënë atyre rolin e boshtit qendror të tërësisë së lëvizjeve dhe të orientimeve në jetën e besimtarit. Frekuentim i shpeshtë i tyre, do të thotë të përgatisësh qenien dhe, bashkë me të, të gjithë shoqërinë myslimane, për të përfituar mirësitë e Allahut të Madhërishëm dhe gjithçka buron prej veprave të mira, që i kryejmë për hatër të Tij. Këto kuptime i gjejmë të shpalosura qartë edhe në Kur'anin Famëlartë, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

"إنما يعمر مساجد الله من آمن بالله واليوم الآخر وأقام الصلاة وآتى الزكاة ولم يخش إلاّ الله فعسى أولئك أن يكونوا من المهتدين"

"Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht, që këta janë në rrugë të drejtë."[25]

Transmetohet prej Profetit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*: "Në Teurat (Torah) shkruhet kështu: 'Në të vërtetë,

[25] Sure "Et Teube", ajeti 18.

shtëpitë e Mia në tokë janë xhamitë. Lum si ata që pastrohen dhe zbukurohen në shtëpitë e tyre dhe më pas vijnë të më vizitojë Mua në Shtëpinë Time'. Nuk ka dyshim se është prej detyrës së të vizituarit, të mbulojë vizitorin me bujarinë e Tij. Jepuni sihariq, të gjithë atyre që ecin në mesin e errësirës për të vizituar xhamitë, se ata do të ndriçohen në Ditën e Gjykimit me dritë të veçantë prej Allahut të Madhëruar."[26]

Përveç frekuentimit të tyre, kërkohet prej nesh që të rrimë sa më gjatë brenda tyre (brenda mundësive), në mënyrë që zemrat tona të lidhen fort pas dritës që përçojnë ato në kraharorë. Kërkohet prej besimtarit të kalojë në xhami një kohë të mjaftueshme, sa për ta lidhur shpirtin e tij me mirësinë që buron prej saj. Kjo është një prej veprave të cilës Islami i ka mëshuar shumë.

Transmetohet prej Profetit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*: "O Ebu Dherr! Për çdo frymëmarrje tënden, gjatë kohës së qëndrimit në xhami, Allahu i Madhëruar të ngre një pozitë më shumë në Ditën e Gjykimit. Engjëjt do të luten dhe do të dërgojnë salavatë për ty. Për çdo frymëmarrje gjatë qëndrimit tënd në xhami, Allahu i Madhëruar do të të

[26] "Uesailush Shija", vëll. 5, f. 245.

shpërblejë me dhjetë të mira dhe do të të fshijë dhjetë të këqija."[27]

Nisur nga sa u përmend më sipër, lind si detyrë për të gjithë myslimanët e devotshëm, që dinë të marrin mbi supet e tyre përgjegjësitë, të përpiqen për të qenë të pranishëm në xhami sa më shumë të jetë e mundur.

Prania jonë në xhami, është e kushtëzuar me një sërë kushtesh dhe rregullash shumë të rrepta, gjithashtu, të lidhura me edukatën e pranisë në xhami. T'i frekuentojmë ato në mënyrë të shpeshtë dhe të vazhdueshme, nuk do të thotë kurrsesi që t'i shndërrojmë ato në shtëpitë apo në vendbanimet tona. Është detyrë e çdo myslimani dhe myslimaneje, që të respektojë pozitën e lartë të xhamisë dhe shenjtërinë e saj. Është e nevojshme që njerëzit të ndiejnë se janë vërtet në praninë e Allahut të Madhëruar. Janë vizitorë të Shtëpisë së Tij. Për këtë arsye, duhet të jenë të kujdesshëm, që të zbatojnë me rigorozitet kodin moral, të lidhur me respektimin e xhamisë dhe rregullat e frekuentimit të saj.

Po të jemi të vëmendshëm, shumë prej këtyre rregullave dhe dispozitave, të lidhura me sjelljen në xhami, i gjejmë të pranishme në transmetimet e ndryshme, të ardhura nga rrugë të ndryshme.

[27] "Biharul Enuar", vëll. 80, f. 370.

Respektimi i xhamive

Përmenden disa rregulla, që lidhen me kodin e sjelljes dhe të etikës gjatë qëndrimit tonë në xhami. Disa prej tyre janë.

1. *Duhet të shmanget kryerja e harameve (e gjynaheve) në xhami*

Transmetohet prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*: "Koha e qëndrimit të besimtarit në xhami, për të pritur faljen e namazit, është prej formave të adhurimit, për sa kohë nuk humbet (juhdith)."

U pyet Profeti i nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*: "O i Dërguari i Allahut! Ç'është humbja (el-hadeth)?!"
Ai tha: "Humbja e vetëdijes."[28]

Kështu, kryerja e harameve (e të ndaluarave fetarisht) dhe veçanërisht përgojimi i të tjerëve gjatë qëndrimit në xhami, është prej veprave që e ngrijnë dhe e zhvlerësojnë veprën e mirë, pra, e humbasin vlerën dhe shpërblimin e qëndrimit në xhami.

[28] "Amalus Saduk", f. 506.

2. *Nuk duhet të ngrihet zëri në xhami*

Transmetohet prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*: "Mos lejoni që xhamitë tuaja të frekuentohen prej njerëzve me të meta mendore, si dhe prej fëmijëve të vegjël. Mos lejoni që zërat tuaja të ngrihen në xhami, përveçse në përmendjen e Allahut."[29]

3. *Mënjanimi i fjalëve të pavlera*

Transmetohet prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*, që kur është pyetur prej Ebu Dherrit *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* rreth popullimit dhe frekuentimit të xhamive, është shprehur: "Mos i ngrini zërat tuaj në xhami dhe mos u merrni me fjalë dhe me debate të kota brenda saj. Mos blini dhe mos shisni brenda tyre. Hiqni dorë prej fjalëve të pavlera, kur të jeni në xhami. Nëse nuk hiqni dorë prej këtyre punëve të ndaluara, Ditën e Gjykimit mos u ankoni përveçse prej veten tuaj."[30]

4. *Kur të vizitoni xhamitë, duhet të keni një veshje që i përshtatet asaj*

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

"خُذُواْ زِينَتَكُمْ عِندَ كُلِّ مَسْجِدٍ"

[29] "Biharul Enuar", vëll. 80, f. 349.
[30] "Uesailush Shija", vëll. 5, f. 234.

"O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm, sa herë që të frekuentoni xhamitë."[31] Hiqni dorë prej sjelljeve që i largojnë njerëzit prej xhamisë. Në një transmetim të Profetit të nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* thuhet: "Ai që ka ngrënë hudhra, të mos i afrohet xhamive tona. Atë mund ta hajë ai që nuk do të vijë në xhami."[32]

5. *Nuk lejohet dhe nuk është e pranueshme që xhamia të përdoret si vend kalimi nga njëri vend te tjetri.*

Është e nevojshme dhe kërkohet prej të gjithë besimtarëve, që të ruajnë autoritetin, dhe shenjtërinë e xhamisë, pasi ajo konsiderohet vendadhurimi. Transmetohet prej Profetit të nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*: "Mos i shndërroni xhamitë tuaja në vendkalime për ju, pa u ndalur dhe pa i falur në to dy rekate namaz."[33]

6. *Gjatë kohës kur besimtari e frekuenton xhaminë dhe qëndron brenda saj, ai duhet ta shpenzojë kohën duke kryer vepra të pëlqyera te Allahu i Madhëruar.*

Lidhur me këtë aspekt, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* thotë: "Të gjitha veprat e frekuentuesit të xhamisë

[31] Sure "El A'araf", ajeti 31.
[32] "Biharul Enuar", vëll. 63, f. 247.
[33] "Mim Nun", vëll. 73, f. 329.

janë të pavlefshme, përveç tre kategorive prej tyre: Këndimi i Kur'anit prej atyre që falen. Fjalët e dala nga goja e besimtarit, që është duke e kujtuar Allahun, ose fjalët e besimtarit që drejton pyetje për të mësuar diçka."[34]

7. *Gjendja shpirtërore gjatë hyrjes në xhami*

Në një transmetim prej Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: "Kur të marrësh vendim për të shkuar në xhami, duhet ta dish mirë dhe ta kesh parasysh se je duke shkelur te dera dhe te shtëpia e një Mbreti të Madh, të cilën nuk e shkelin përveçse të pastruarit. Vetëm të drejtëve dhe të sinqertëve të mëdhenj, u lejohet të frekuentojnë kuvendet e Tij. Duhet ta dish mirë se, kur ta shkelësh shtëpinë e Mbretit, duhet t'i shërbesh Atij. Duhet ta dish mirë, gjithashtu, se, nëse nuk je i vëmendshëm ndaj autoritetit të Tij, je i ekspozuar ndaj një rreziku të madh. Duhet ta dish mirë se Allahu i Madhëruar është i Plotfuqishëm dhe vetëm Ai e ka në dorë të të mbulojë me drejtësinë dhe mirësinë e Tij në tokë. Përulu dhe përgjërohu përpara Madhështisë së Tij dhe shprehi Atij pafuqinë dhe pamundësinë tënde të madhe. Sa herë shkon të kërkosh prehjen dhe qetësinë te Allahu i Madhëruar, tregoja dhe dorëzoja Atij të fshehtat e tua të mëdha, edhe pse Ai i di mirë të gjitha ato. Ji i vetëdijshëm se asgjë në qiej dhe në tokë nuk mund t'i fshihet Allahut të Madhëruar. Asnjë krijesë, në këtë ekzistencë, nuk mund t'i mbajë të

[34] "Mim Nun", vëll. 74, f. 86.

fshehta Atij. Ai është i mirinformuar për gjithçka që shfaqin dhe gjithçka që fshehin. Tregoje, shfaqe dhe mos u druaj ta konsiderosh veten si krijesa më e dobët, sa herë të gjendesh duke u lutur në praninë e Tij. Pastroje zemrën tënde dhe zbraze atë prej gjithçkaje që mund të bëhet pengesë mes teje dhe mes Allahut të Madhëruar, sepse Ai nuk pranon prej veprave, përveçse atë që është me e pastra dhe më e sinqerta. Përpiqu të kuptosh se cila është pozita në të cilën gjendesh. Përpiqu të kuptosh, nëse zemra jote ka nisur të ëmbëltohet prej ëmbëlsisë së adhurimit të Tij. Përpiqu të kuptosh, nëse e ke shijuar apo ende nuk e ke shijuar kënaqësinë që të fal mëshira dhe bujaria e Tij e madhe. Përpiqu të kuptosh, nëse ke pirë prej gotës së përgjigjes, kur vendos t'i përgjigjet lutjes Ai. Nëse i ke shijuar të gjitha këto, nëse i ke ndier të gjitha këto, nëse të gjitha këto përjetime hyjnore e kanë takuar qiellzën e shpirtit tënd, atëherë kuptoje se ti je njeriu i përshtatshëm për t'u vënë në shërbim të Tij. Je ti njeriu, të cilin Allahu i Madhëruar do ta përfshijë me paqen dhe sigurinë që burojnë vetëm prej Tij. Në të kundërt, në rast se nuk realizon asnjërën prej këtyre, i humburi je ti. Në rast se nuk i prek të tilla ndjenja dhe të tilla përjetime, do të mbetesh një njeri i pafuqishëm, i këputur e shpresëhumbur, pa asnjë vlerë. Do të mbetesh si një njeri që e shpenzon kohën e jetës së tij pa asnjë vlerë. Nëse Allahu i Madhëruar do të shohë sinqeritetin në zemrën tënde dhe në shpirtin tënd, nëse Ai do të dëshmojë dashurinë dhe dëshirën tënde për

udhëzimin dhe njohjen e Tij, do të shohë me syrin e mëshirës, të butësisë dhe të dhembshurisë. Allahu do të ndihmojë të jesh vepërmirë dhe të konsiderohesh prej atyre që e meritojnë kënaqësinë e Tij. Ai është Bujar i Madh dhe i pëlqen që ta ushtrojë bujarinë e Tij me njerëzit në nevojë. Të Madhërishmit Allah, i pëlqen të mbulojë me Mëshirën e Tij të gjithë ata që përgjërohen me përulje te dera e Tij, vetëm për të kërkuar kënaqësinë e Tij.
Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

"أَمَّن يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ..."

"**Cili është Ai që u përgjigjet nevojtarëve kur luten?!"**[35]

Imami Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)*, pasi e përmend të gjithë transmetimin e mësipërm, e komenton atë dhe thotë: "Duket qartë se hadithi i mësipërm, në tërësinë e tij, është kushtetutë më vete për sjelljet, moralin dhe orientimin shpirtëror të adhuruesve të mëdhenj. Kjo është arsyeja kryesore përse e solla atë në mënyrë të plotë. Kisha shpresë se ky transmetim i plotë, do ta ndihmojë këtë kategori njerëzish të mendojë dhe të meditojë edhe më shumë. Ajka e përmbajtjes së shprehjes profetike, kur thuhet: "Kur të mbërrish te dera e xhamisë, kujtohu mirë se në portën e cilit je duke trokitur. Kujtohu mirë se cilat Xhenete je duke kërkuar.", është një ftesë indirekte e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*, për të kuptuar se vendi ku

[35] "Biharul Enuar", vëll. 80, f. 374.

kemi shkuar dhe vendi për ku jemi drejtuar është dera e Mbretit më të madh në ekzistencë. Është dera e Atij që, sapo shkelet prej njeriut, shndërrohet në një krijesë të pastër. I pastër prej papastërtive të tokës. I pastër prej papastërtive të shejtanit të mallkuar, që i nxin zemrat me blozën e gjynaheve.

Allahu i Madhëruar nuk e jep lejen për t'u afruar hapësirave të Tij të shenjta përveçse njerëzve të pastër, të çiltër dhe të sinqertë, që e kërkojnë me ngulm afrimitetin e Tij. Ajo leje u lëshohet vetëm atyre besimtarëve, që e kanë pastruar veten prej formave të dukshme dhe të padukshme të idhujtarisë e të politeizmit. Është detyra jote kryesore, besimtar dhe besimtare e nderuar, që ta shndërrosh Autoritetin, Madhështinë dhe Krenarinë e të Gjithëpushtetshmit në dritën e syve të tu. Pasi të kesh realizuar me sukses këtë transformim shpirtëror, atëherë bëhu gati të prekësh Parajsën e Tij të madhe dhe bashkë me të të shkelësh në qilimin e shtruar me paqe të përjetshme, prehje e qetësi. Tashmë je një anëtar i bekuar dhe fatlum, që endesh hapësirave të magjishme të mbretërisë së Tij, atje ku Caktimi i Tij e lëviz gjithçka, sipas një projeksioni të shenjtë dhe të mahnitshëm. Tashmë gjendesh te paradhomat e përjetësisë dhe anekset e saj. Gjendesh përballë Krijuesit të Gjithësisë, i Cili ka në dorë fatin tënd të përjetësisë. I Gjithëmëshirshmi, Bujari dhe Falësi i Madh ka në dorë gjithçka dhe ti, o njeri, gjendesh

përballë një rreziku të madh: ose Allahu i Madhëruar vendos me Mëshirën e Tij të Madhe të marrë në konsideratë adhurimet e tua modeste, që edhe në qofshin sa një mal i lartë, mbeten të vogla, në krahasim me Mirësitë e Tij të Mëdha, ose të përfshin në Amnistinë e Tij të Madhe dhe shpërblen veprat e tua të vogla me shpërblimin e Tij të Madh, ose mund të ndodhë krejtësisht e kundërta. Je ti ai që e vlerëson momentin, nëse është i vështirë e kritik apo jo. Nëse e vlerëson vërtet rëndësinë e këtij takimi, nëse e vlerëson vërtet rëndësinë e kësaj Dite të madhe, atëherë duhet ta pranosh me fuqinë e shpirtit dhe të zemrës dobësinë, pafuqinë dhe varfërinë tënde të madhe përpara Krijuesit të botëve. Kur të shkosh për ta adhuruar Atë dhe, kur të shkosh për të kërkuar qetësinë dhe prehjen te dyert e Mëshirës dhe të prehjes së Tij, zbraze shpirtin, qenien dhe zemrën prej gjithçkaje tjetër dhe boshatisi ato vetëm për të madhërishmin Allah. Mos lejo që askush tjetër në ekzistencë të ndërhyjë te mendimet dhe te shqetësimet e shpirtit tënd, sepse kjo e komprometon dorëzimin e shpirtit te Hapësirat e shenjta të Afrimitetit dhe e vesh atë me një pëlhurë të dyshimtë politeizmi dhe idhujtarie të fshehtë. Allahu i Madhëruar pranon vetëm zemrat e pastra dhe plotësisht të sinqerta, që i dorëzohen Atij. Nëse gjen te vetja dhe e prek thellësive të shpirtit tënd ëmbëlsinë e përuljes ndaj Allahut dhe të përmendjes së Tij, nëse e gjen veten të përfshirë prej Mëshirës së Tij të Madhe, prej Faljes së Tij të Madhe, nëse e gjen veten të përfshirë prej

mrekullive të Tij të ndryshme dhe pjesë e pranimit të Tij, atëherë duhet të kuptosh se je i denjë për të qenë një shërbëtor te hapësirat e Afrimitetit të Tij. Kjo është leja e përjetësisë për t'u futur në Parajsë dhe për të qëndruar aty i qetë dhe i sigurt.

Nëse e gjen veten të përfshirë në gjendje të tilla, atëherë qëndro te dera e madhe e Mëshirës së Tij dhe tregoje aty dobësinë tënde karshi Allahut të Madhëruar. Kur t'i tregosh Allahut të Madhëruar dobësinë tënde të madhe, kur të shpalosësh përpara Pranisë së Tij së Shenjtë pafuqinë tënde dhe dorëzimin e plotë të qenies, duke e vënë fatin, të ardhmen dhe caktimin në dispozicion të Krijuesit të Gjithësisë dhe, kur Ai të shohë te zemra jote sinqeritet dhe përulësi, ka për ta mbuluar atë me paqe, prehje, mëshirë e qetësi. Është Ai, i Lartësuari Allah, që e mbulon qenien tënde me ndihmë e mbështetje, që ti të ndjekësh rrugën dhe Kënaqësinë e Tij. Është i Gjithëpushtetshmi Allah, Ai që e mbulon robin e Tij të nënshtruar me format e ndryshme të ndihmës, mbështetjes, mëshirës, faljes e bujarisë.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

"أَمَّن يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ"

"Cili është Ai, që i përgjigjet nevojtarit kur ka nevojë?! Cili është Ai që e largon të keqen, përveç Allahut?!"[36]

Si përfundim, lidhur me këtë pjesë të temës sonë, mund të themi se popullimi i xhamive dhe frekuentimi i tyre, është obligim fetar dhe një tjetër detyrë që shfaqet është respektimi i normave të mirësjelljes.

[36] "Al Adab El Ma'aneuijeh Lis Salat" - "Normat morale të namazit", f. 187-188.

Nderimi i frekuentuesve të xhamisë te Allahu i Madhëruar

Xha'afer bin Muhamedi ka transmetuar prej baballarëve të tij *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se Allahu i Madhëruar ka thënë: "Po të mos kishin qenë ata që duhen për hatrin Tim dhe ata që i popullojnë dhe i frekuentojnë xhamitë e Mia, po të mos kishin qenë ata që i kërkojnë Allahut falje në zemrën e natës, po të mos kishin qenë këto kategori njerëzish, Allahu i Madhëruar do të kishte dërguar për njerëzimin ndëshkimin dhe dënimin e Tij të madh."[37]

Pyetja që lind është: Cili është qëllimi prej frekuentimit të xhamive? Çfarë përfitohet prej kësaj dukurie? Çfarë të mirash i vijnë individit dhe shoqërisë myslimane, nëse ndiqet kjo praktikë dhe nëse vendoset një traditë e tillë?!

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* ka hedhur dritë dhe ka sjellë për lexuesin disa prej transmetimeve të rëndësishme islame. Këto transmetime i ka provuar edhe aktualiteti, edhe përditshmëria.

Le të ndalemi së bashku dhe t'i hedhim një sy.

[37] "Uesailush Shija", (Alul Bejt), El Hirrul Amilijj, vëll. 5, f. 204.

KAPITULLI I TRETË

ROLI I XHAMISË NË FORMIMIN E INDIVIDIT

Xhamia, formuese e brezave të rinj besimtarë

Edukata ka rëndësi shumë të madhe në formimin e individit mysliman. Ajo luan një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kushteve dhe të klimës së përshtatshme emocionale, shpirtërore dhe mendore të njeriut, për ta ndjekur të vërtetën dhe për t'i orientuar energjitë e tij në drejtimin e duhur. Fundi i kësaj rruge është i mirëpërcaktuar, lumturi në këtë botë dhe mirësi e shpërblim në Botën Tjetër.

Në aspektin e edukimit dhe të formimit moral të individit, xhamia ka një rol shumë të rëndësishëm.

Imam Khomeini *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë kështu: "Xhamitë duhet të jenë qendra për edukimin e myslimanit sipas normave islame. Unë mendoj se pjesa më e madhe e xhamive këtë rol ka."[38]

Në një tjetër deklaratë, Imami i nderuar *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)*, thotë: "Xhamitë duhet të jenë vendet ku mësohet feja, edukata, morali dhe shkenca e vërtetë, në të gjitha dimensionet e fjalës shkencë."[39]

Xhamia është toka, është dheu ku kemi mbjellë njeriun besimtar. Ai rritet me kalimin e kohës si një pemë dhe i jep frytet me lejen e Zotit të vet. Ajo është pema që është ushqyer dhe është ujitur prej dheut të xhamisë. Ajo është pema, degët e të cilës janë rritur, derisa kanë prekur qiellin. Ajo është pema e ndritur, e mbushur me frute. Rrënjët i ka në tokë, degët i ka në qiell.

Transmetohet prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*: "Ata njerëz që e frekuentojnë shpesh xhaminë do të kenë cilësitë e mëposhtme: Shenjë të qëndrueshme, obligim i praktikuar, traditë profetike që ecën në këmbë, dije dhe shkencë, fjalë që udhëzon në të mirë dhe ndalon nga e keqja, largues gjynahesh prej frikës ose prej turpit."[40]

[38] "Kelimatun Kisar", f. 64.
[39] "Mim Nun".
[40] "Biharul Enuar", vëll. 81, f. 2.

“Nëse njeriu e frekuenton rregullisht xhaminë, ai nis e merr prej virtyteve të larta, bëhet përfitues i drejtpërdrejtë i mirësive të Zotit dhe bëhet prej të udhëzuarve. Allahu i Madhëruar thotë në Kur’anin Famëlartë:

"إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسَاجِدَ اللّهِ مَنْ آمَنَ بِاللّهِ وَالْيَوْمِ الآخِرِ وَأَقَامَ الصَّلاَةَ وَآتَى الزَّكَاةَ وَلَمْ يَخْشَ إِلاَّ اللّهَ فَعَسَى أُوْلَئِكَ أَن يَكُونُواْ مِنَ الْمُهْتَدِينَ

“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”

Bazuar mbi ajetin e mësipërm, mund të themi se xhamia është vend udhëzimi. Nëse dëshiron të kesh nesër një njeri të ndershëm dhe të devotshëm, atëherë mbille sot në dhè të pastër. Nëse e mbjell atë te shkretëtirat e kësaj bote dhe te malet e saj të zhveshura dhe konstaton se nuk ka për ta prekur udhëzimin, atëherë kërkoje fajin te vetja jote.

Xhamia, kështjella e fortifikuar e përpjekjes (xhihadit)

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë kështu: "Mihrabi është vendi i luftës. Ai është qartësuesi i përballjes dhe i luftës kundër djajve dhe kundër tiranëve."[41]

Në këtë shprehje të tij, Imami i nderuar *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* sqaron dhe hedh dritë mbi dy dimensione shumë të rëndësishme të luftës. I pari, është lufta kundër nefsit (kundër egos/epshit). Dimensioni i dytë është lufta kundër diktatorëve dhe kundër tiranëve të kësaj bote.

Xhihadin (përpjekjen) kundër tiranëve dhe diktatorëve do ta trajtojmë në vijim. Për momentin do të ndalemi te xhihadi (përpjekja) që bëhet kundër vetes, kundër egos, kundër epshit. Fakti që numri i transmetimeve që flasin për këtë lloj xhihadi është shumë i madh, tregon se ky lloj xhihadi dhe kjo lloj përpjekje është më e rëndësishmja. Për këtë arsye, ai përmendet nëpër transmetimet e ndryshme si "xhihadi më i madh" ose "përpjekja më e madhe".

[41] "Kelimatun Kisar", f. 64.

Vërtet, kjo është lufta më e madhe. Kjo është beteja më e përgjakshme dhe më e vështirë, ndikimet e të cilës reflektojnë drejtpërsëdrejti në jetën e kësaj bote dhe në Botën Tjetër. Kjo është një luftë që zhvillohet kundër të gjithë djajve të mbledhur bashkë, kundër të gjitha energjive dhe fuqive të errëta, si dhe kundër epsheve dhe joshjeve të pafundme të kësaj bote mashtruese dhe kalimtare.

Çdo luftë ka taktikat e saj, ka bazat e saj, sikurse ka edhe frontin, hendeqet dhe vendstrehimet e saj. Ajo që duhet të ngulisim thellë mendjeve tona, ne, si besimtarë, është fakti se xhamia është fronti, vendstrehimi dhe hendeku ynë në këtë luftë të madhe. Në këto kushte, të braktisësh xhamitë, do të thotë të ekspozosh veten tërësisht i zhveshur dhe i zbuluar përballë shigjetave të armiqve dhe veglave të tyre. Kjo, për ata që kanë dëshirë ta pranojnë dhe për ata që nuk kanë dëshirë ta pranojnë, do të thotë të ekspozosh veten ndaj vrasjes, ndaj shkatërrimit dhe ndaj eliminimit fizik. Kjo do të thotë, për të gjithë ata që e njohin artin e luftës, një dorëzim pa kushte dhe një humbje e plotë e luftës.

Xhamia është siguria më e madhe, madje e vetmja që na ndihmon ne të fitojmë këtë luftë të madhe dhe të një saktësie të lartë.

Ky është një dimension shumë i rëndësishëm, të cilin e gjejmë të pranishëm edhe te transmetimet që na

vijnë nga prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Në njërin prej këtyre transmetimeve, ai thotë: "Të gjithë ata besimtarë që i frekuentojnë vazhdimisht xhamitë, do të përfitojnë minimalisht këto mirësi të mëdhaja: Një vëlla besimtar që e duam për hatër të Zotit. Dije e marrë në mënyrë të pandërprerë. Mësimin e një ajeti kur'anor. Mëshirën e shumëpritur të Allahut. Një fjalë të mirë, që e ndalon nga e keqja. Heq dorë prej një gjynahu, ose prej frikës prej Allahut, ose prej turpit prej tij."

Në një tjetër transmetim, nga i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*, citohet: "Më e pakta që mund të përfitojë një besimtar prej frekuentimit të shpeshtë të xhamisë, është njëra prej tre mirësive të mëdha: Një lutje e sinqertë, drejtuar Allahut të Madhërishëm, që bëhet shkak për ta futur atë në Xhenet. Një lutje e sinqertë, drejtuar Allahut të Madhëruar, që bëhet shkak që Ai të largojë prej tij një fatkeqësi të madhe. Një vëlla mysliman që e do vetëm për hir të Allahut."[42]

Xhamia është një institucion shumë i rëndësishëm, që ndikon në formimin e një personaliteti të denjë prej besimtari, i cili mban mbi shpatullat e tij shqetësimet e fesë së Zotit dhe mesazhin e saj. Xhamia është institucioni edukativ më i rëndësishëm i shpirtit, i mendjes dhe i

[42] "Biharul Enuar", vëll. 71, f. 275.

zemrës, që e ndihmon njeriun të përballet me vështirësitë e kësaj bote dhe me joshjet e saj mashtruese.

Pyetja që lind, pasi përballemi me transmetime dhe me kuptimet e sipërpërmendurat, është: A janë këto fjalë tregues se ndikimet e rolit të xhamisë janë të përqendruara vetëm te dimensioni individual?! Apo roli i xhamisë është shumë më i gjerë dhe shumë më gjithëpërfshirës se kaq?! Nuk ka dyshim se roli i xhamisë është shumë më i gjerë se ndikimet e saj në rrafshin individual. Rreshtat në vijim do t'i kushtohen pikërisht këtyre dimensioneve.

KAPITULLI I KATËRT

ROLI I XHAMISË NË SHOQËRI

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Xhamia është një prej hendekëve më të rëndësishëm të Islamit dhe mihrabi (vendi nga ku imami prin namazin) është fushëbeteja e tij. Ata duan ta rrëmbejnë prej duarve tuaja këtë pasuri të madhe. Në fakt, mund të them me bindje se ky është vetëm fillimi i synimeve të tyre. Ky është halli i tyre më i madh, përndryshe ata nuk kanë asnjë problem tjetër. Shkoni e faluni sa të dëshironi. Ata ndihen të atakuar, të sulmuar dhe të prekur prej rolit të xhamisë këto dy tre vitet e fundit. Xhamitë janë shndërruar në qendra të rëndësishme, te të cilat grumbullohen njerëzit. Ato janë shndërruar në qendra të rëndësishme të mobilizimit shpirtëror dhe revolucionar, për të gjithë ata që synojnë të luftojnë padrejtësitë dhe tiranitë. Ky është hendeku juaj më i madh dhe unë po ju paralajmëroj. Ata

duan ta marrin prej jush këtë hendek. Duan t'ju lenë pa të."[43]

Është e rëndësishme të dihet prej të gjithëve se xhamia ka një rol qendror në jetën edhe në përditshmërinë e shoqërisë. Përsa i përket parullës "Jepi Zotit atë që i takon Zotit dhe Cezarit atë që i takon Cezarit.", qëndron shumë larg kuptimeve dhe koncepteve elementare të Islamit, madje ajo është një ftesë që qëndron shumë larg kërkesave themelore të Islamit dhe praktikave të lidhura me të. Islami është një fe e natyrshmërisë, që lind bashkë me njeriun dhe ai është një amalgamë, ku ndërthuret mrekullisht teoria dhe praktika. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "وأينما تولوا فثمّ وجه الله" **"Ngado që të drejtoheni, ajo është ana e Tij** (e Allahut)**."**.

Ai (Allahu) është i adhuruari me të drejtë, është Sunduesi i përgjithshëm, Ndihmuesi dhe Mbështetësi në çdo vështirësi. Ai është Rregullatori dhe Mbikëqyrësi i gjithçkaje që ndodh ne ekzistencë.

Për këtë arsye, që në fillimet e saj, xhamia ka qenë qendra më e rëndësishme shpirtërore e myslimanëve dhe qendra ku e kanë pasur pikënisjen e tyre të gjitha punët dhe angazhimet e myslimanëve përgjatë historisë.

[43] "Menhexhijetuth Theureh" - "Metodika e Revolucionit", f. 479.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Gjatë kohës së Profetit tonë të dashur *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* Mesxhidi Harami (Qabeja e nderuar) dhe të gjitha xhamitë e tjera kanë qenë qendra, ku myslimanët organizonin dhe bënin planet e betejave të tyre më të rëndësishme. Ato kanë qenë njëkohësisht qendra shumë të rëndësishme të lidhura me të gjitha dimensionet sociale, politike dhe ekonomike të jetës së myslimanëve.

Xhamia e Profetit tonë të dashur *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* ka qenë një institucion shumë i rëndësishëm, madje mund të themi se ka qenë institucioni më i rëndësishëm shoqëror, ekonomik dhe politik i kohës. Roli i saj nuk ka qenë kurrë i kufizuar në çështjet adhuruese të besimtarëve. Të gjithë ata që kanë njohuri minimale rreth historisë islame dhe të Profetit të nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* janë të mirinformuar se ajo xhami ka shërbyer për të përgatitur ushtritë për në luftë."[44]

Le të përmendim këtu disa prej këtyre roleve dhe dimensioneve të xhamisë.

[44] "Menhexhijetuth Theureh", f. 478.

Roli shoqëror

Xhamia ka një rol të veçantë dhe shumë të rëndësishëm në forcimin e unitetit shoqëror dhe të gjetjes së një bashkëpunimi të shkëlqyer midis të gjitha shtresave të shoqërisë, që nga ato më pak të rëndësishmet e deri te shtresat e larta. Ky lloj solidariteti ka qenë, gjithashtu, objekt i Zbulesës Hyjnore, pasi Allahu i Madhëruar ka zbritur një sërë dispozitash dhe rregullash që rregullojnë marrëdhënien e anëtarëve të shoqërisë ndërmjet njëri-tjetrit, si dhe vëllazërimin e tyre në Islam. Të shumta janë rregullat dhe dispozitat e përmendura në Zbulesën Hyjnore dhe në traditën profetike, të cilat vendosin normat e sjelljes midis besimtarëve. Rregulla të tilla vijnë për ta mësuar njeriun si të sillet më vëllain e tij njeri, në mënyrë që shtresat e ndryshme të shoqërisë të jenë të lidhura fort me njëra-tjetrën. Lidhur me këtë aspekt, xhamia dhe veçanërisht namazi në grup, ka një rol shumë të rëndësishëm. Kjo do të thotë që myslimanët të mblidhen në xhami minimalisht tre herë në ditë.

Disa transmetime na tregojnë rëndësinë e nisjes për në xhami, më qëllim (nijet) përfitimin e shpërblimit që vjen prej namazit në grup (me xhemat).

Prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* transmetohet: "Çdonjëri prej jush, që i drejtohet xhamisë, me qëllim faljen e namazit në grup (me xhemat), Allahu do të regjistrojë për të, për çdo hap të kryer në drejtim të saj, shtatëdhjetëmijë të mira si shpërblim. Kjo do të rrisë, gjithashtu, me shtatëdhjetëmijë herë pozitat e tij te Allahu i Madhëruar. Nëse ndahet nga jeta në atë gjendje, Allahu i Madhëruar do të dërgojë për të shtatëdhjetëmijë engjëj ta vizitojnë atë në varr, ta ngushëllojnë në vetminë e varrit dhe të luten për të deri në Ditën e Gjykimit."[45]

Për sa kohë ai bëhet prej frekuentuesve të vazhdueshëm të xhamisë, ashtu siç u përmend edhe në hadithin e mësipërm, ai do të përfitojë jo më pak se njërën prej tre mirësive të mëdha: Një lutje e sinqertë, drejtuar Allahut të Madhërishëm, që bëhet shkak për ta futur atë në Xhenet. Një lutje e sinqertë, drejtuar Allahut të Madhëruar, që bëhet shkak që Ai të largojë prej tij një fatkeqësi të madhe. Një vëlla mysliman, që e do vetëm për hir të Allahut."[46]

[45] "Mizanul Hikmeh", vëll. 2, f. 1259.
[46] "Biharul Enuar", vëll. 71, f. 275.

Roli përcjellës dhe transmetues

Përveç të tjerave, xhamia është një qendër shumë e rëndësishme mediatike dhe komunikimi me njerëzit. Të gjithë ata që synojnë të ndriçohen dhe të marrin prej dijeve të ndryshme, duhet të frekuentojnë xhaminë. Të gjithë ata që synojnë udhëzimin e Allahut të Madhëruar, le të vizitojnë sa më shpesh xhamitë. Të gjithë ata që synojnë pendesën, ajo gjendet te dera e Shtëpisë së Allahut. Xhamia është vendi, në të cilin gjendet më e përqendruar se kudo tjetër Mëshira e Madhe e Allahut, ndaj të gjithë ata që synojnë sukses në këtë botë dhe sukses në Botën Tjetër, le ta frekuentojnë sa më shumë që të munden atë.

Kjo është një çështje, e cila ndriçohet edhe prej një transmetimi të prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "Të gjithë ata besimtarë, që i frekuentojnë vazhdimisht xhamitë, do të përfitojnë minimalisht këto mirësi të mëdhaja. Një vëlla besimtar, që e duam për hatër të Zotit. Dije e marrë në mënyrë të pandërprerë. Mësimin e një ajeti kur'anor. Mëshirën e shumëpritur të Allahut. Një fjalë të mirë, që e ndalon nga e keqja. Heq dorë prej një gjynahu, ose prej frikës prej Allahut, ose prej turpit prej Tij."[47]

[47] "Mim Nun", vëll. 80, f. 351.

Të tjera transmetime shumë të njohura vijnë për të hedhur dritë dhe për të vënë theksin mbi rolin edukativ dhe mësimor të xhamisë. Një herë, Profeti i nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*, kur shkoi në xhami, kishte parë dy grupe njerëzish. Njëri prej tyre mësonte prej dijeve të fesë, kurse grupi tjetër i lutej Allahut dhe kërkonte falje prej Tij. Profeti i nderuar tha: "Të dyja grupimet janë duke bërë punë të lavdëruar. Njëra palë adhuron me përkushtim Allahun e Madhëruar dhe i lutet Atij, ndërsa pala tjetër shëron paditurinë me dije dhe me mësimet e fesë. Këta që mësojnë, janë arsyeja për të cilën jam dërguar. Pasi tha kështu, u ul me këta të fundit."[48]

Është e kotë të flitet më shumë dhe është e kotë të komentosh më tepër. Të gjithë e përfytyrojmë dhe e imagjinojmë ç'do të thotë një kuvend dijesh, pjesë e të cilit është vetë i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*. Është e drejta e çdo myslimani, që të shpresojë dhe të ëndërrojë për një kuvend dije të tillë.

Xhamia është një qendër shumë e rëndësishme mediatike dhe informimi. Ky është një dimension tjetër shumë i rëndësishëm, gjithashtu, rreth të cilit ka hedhur dritë Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)*. Lidhur

[48] "Munjetul Mezid, f. 106.

me këtë dimension të xhamisë, Imami i nderuar *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë kështu: "Xhamia është qendra më e rëndësishme e medias dhe e informimit të myslimanëve."[49]

Ai thotë, gjithashtu: "Qendra kryesore e medias islame ka qenë xhamia."[50]

[49] "Kelimatun Kisar", f. 64.
[50] "Menhexhijetuth Theureh", f. 478.

Roli politik

Prej veçorive më të rëndësishme të Islamit është gjithëpërfshirja e tij. Nisur nga mëshira dhe dashuria e madhe për krijesat e veta, Allahu i Madhëruar kishte për qëllim të plotësonte të gjitha nevojat e njeriut në këtë botë, përfshi edhe nevojat legjislative, të cilat janë siguria e vetme dhe më e madhe, për të arritur lumturinë e njerëzve në këtë botë dhe shpëtimin në Botën Tjetër. Islami nuk ka ardhur thjesht për të sjellë rekomandime nga lart. Nuk ka ardhur thjesht për të dhënë urdhra për përmirësim, për ndryshim dhe për t'u reformuar, por bashkë me këto orientime dhe këshilla ka sjellë edhe platformën ligjore, me zbatimin e së cilës mund të realizohet ky program reformues i shoqërisë. Islami ka ardhur për të konstatuar dhe për të diagnostifikuar saktë problematikat e shoqërisë njerëzore dhe bashkë me sugjerimet, ka sjellë edhe ilaçin e duhur për secilën prej sëmundjeve, sikurse e ka urdhëruar njeriun ta përdorë atë ilaç.

Kjo është prej arsyeve kryesore përse Kur'ani Famëlartë i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe aspekteve të ndryshme të jetës shoqërore. Ai është interesuar për gjithçka që ka lidhje me jetën e njerëzve, madje edhe me orientimet e tyre politike dhe i ka trajtuar ato nevoja sipas këndvështrimeve shumë të sakta, në varësi

të kushteve dhe të veçorive historike të secilës kohë. Islami ka ardhur për t'u interesuar për moralin, për normat e sjelljes në një shoqëri, sikurse ka ardhur për të trajtuar çështjet e paqes dhe të luftës. Nuk është aspak e çuditshme ta shihni një ditë xhaminë, që është hedhur në politikë dhe e ka zbukuruar atë me mirësinë dhe me butësinë që përfaqëson. Ta ndriçojë atë me Udhëzimin e mrekullueshëm Hyjnor.

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë kështu: "Xhamitë janë qendra të grupimeve dhe të ideve politike."[51]

Nisur nga sa u përmend më sipër, mund të themi se Islami është shumë i interesuar për politikën dhe ajo zë një vend të veçantë në shqetësimet dhe dispozitat e tij. Profeti i nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* përveç se i Dërguar i Allahut, ka qenë njëkohësisht kryepolitikani apo kreu dhe personaliteti më i lartë shtetëror në qeverinë islame. Ai përfaqësonte majën e piramidës në drejtimin e shoqërisë islame. Organizimi politik ka qenë një prej elementeve dhe tipareve kryesore që e ka karakterizuar xhaminë.

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* ka thënë kështu: "Xhamia e Profetit *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* nuk ka pasur një

[51] "Kelimatun Kisar", f. 64.

profil posaçërisht adhurues. Roli i asaj xhamie nuk ka qenë për të trajtuar vetëm çështjet e lidhura me agjërimin dhe me namazin, por ka pasur, gjithashtu, rol formues dhe orientues politik."[52]

Xhamia në Iran arriti të ndryshojë të gjitha ekuilibrat e forcave dhe nëpërmjet saj u realizua përballja e drejtpërdrejtë me tiranitë dhe fuqitë e errëta të kohës. Kjo është ajo që arriti të ndryshojë Revolucioni Islamik në Iran. Lidhur me këtë, Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur prej tij!)* thotë: "Xhamitë janë ato që i siguruan triumfin dhe fitoren popullit iranian. Ishin xhamitë, terreni prej të cilit mori vrull Revolucioni Islamik i popullit iranian. Xhamitë janë qendra shumë të rëndësishme dhe është detyrë e të gjithë popullit që të përkujdeset për to."[53]

Xhamitë janë kështjella të fortifikuara, të cilat Allahu i Madhëruar i ka vendosur në tokë. Për këtë arsye, duhet të përfitojmë prej tyre.

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë, gjithashtu: "Jepini jetë Revolucionit nëpërmjet xhamive tuaja, sepse ato konsiderohen kështjellat e fortifikuara të Islamit. Jepini ngjyrën Revolucionit duke e mbushur atë thirrje islame."[54]

[52] "Menhexhijetuth Theuretil Islamijeh", f. 478.
[53] "Menhexhijetuth Theuretil Islamijeh", f. 478.
[54] "Kelimat Kisar", f. 65.

Roli luftarak

Xhamia ka qenë e pranishme fuqimisht edhe në lëvizjen luftarake dhe ushtarake të myslimanëve përgjatë historisë. Ajo janë konsideruar historikisht si pikënisja strategjike e të gjitha ushtrive të myslimanëve në mbrojtje të Islamit dhe për të çuar sa më lart fjalën "La Ilahe Ilall-Llah".

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Xhamia e Profetit *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* dhe të gjitha xhamitë e tjera përgjatë historisë islame, kanë qenë baza të rëndësishme lufte."[55]

Kështu, pra, xhamia ka qenë, gjatë gjithë historisë, boshti kryesor rreth të cilit është orientuar lëvizja e myslimanëve. Ajo ka qenë epiqendra në të cilën myslimanët kanë mbushur depot e tyre të zemrës dhe të shpirtit dhe, prej mirësisë së duave dhe të namazeve, janë furnizuar me moral, optimizëm dhe forcë, për të zhvilluar betejat e tyre të nderit. Xhamitë kanë shërbyer, që myslimanët të furnizohen me dituritë dhe me njohuritë që i afrojnë me Krijuesin e Gjithësisë. Nëpërmjet atyre dijeve dhe njohurive ata u njohën me urdhëresat dhe ndalesat.

[55] "Menhexhijetuth Theuretil Islamijeh", f. 478.

Ato xhami kanë shërbyer si streha meditimi për të gjithë të pasionuarit pas halleve të myslimanëve dhe të ymetit (popullit islam). Ato xhami kanë qenë burimi kryesor i atyre energjive të pastra njerëzore, që janë shndërruar pas besimit dhe furnizimit me dritë, në shpata prej shpatave të Allahut në tokë.

PËRFUNDIMI

Mbrojini xhamitë

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "O ju popull i Iranit! Ruajini xhamitë tuaja. O ju intelektualë të popullit tim! Mbrojini xhamitë dhe mos u bëni si intelektualët perëndimorë. Juristë të nderuar të vendit tim! Mbrojini xhamitë…"[56]

Mbrojtja e xhamisë është detyrë e shenjtë për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Kjo është cilësia që e dallon intelektualin mysliman nga intelektuali në Perëndim. Intelektuali mysliman e sheh rolin qendror të xhamisë te të qenit Shtëpi e Allahut të Madhëruar, që është Zoti i gjithçkaje. Mbrojtje e xhamive, nuk do të thotë të marrësh në mbrojtje muret, gurët dhe dyert e tyre, por të marrësh në mbrojtje rolin e saj qendror dhe thelbësor në tërësinë e jetës së njeriut. Kjo është e vetmja mënyrë për t'u shndërruar në brezin që i përket xhamive. Kjo është e vetmja mënyrë për të furnizuar qenien dhe për ta bashkuar gjakun e damarëve tanë me mirësinë, me pozitivitetin dhe

[56] "Kelimatun Kisar", f. 64.

me dritën që përcjell xhamia thellësive të qenies. Detyra jonë në këtë shekull është pikërisht kjo.

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Duhet ta deklaroj me gjithë fuqinë e qenies sime: Mbrojtja e xhamive është sot detyra më e madhe e myslimanëve."[57]

Kjo është detyra jonë më e madhe, te e cila duhet të përqendrohemi më shumë se gjithçka tjetër. Çdo lloj hutie apo nënvlerësim i kësaj pasurie të rëndësishme të myslimanëve sot, përkthehet në dobësi të hendekut më të rëndësishëm të shoqërisë islame, ç'ka mund të shkaktojë shembjen e plotë të shoqërisë sonë islame. Ky zhvillim i rrezikshëm shkakton dobësimin e frymës së Islamit (Zoti na ruajttë!). Dobësimi i xhamisë është themeli, burimi dhe origjina e çdo lloj dobësie tjetër.

Imam Khomeini *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* thotë: "Nuk ka dyshim se mbrojtja e xhamive është elementi dhe aksioni më i rëndësishëm, nëpërmjet të cilit mund të mbrohet shoqëria islame."[58]

Zoti ynë! Na bëj ne prej frekuentuesve të xhamisë! Na bëj ne prej atyre që jetuan me xhaminë dhe e përjetuan thellësisht atë, derisa të shndërrohet në frymë që e pushton qenien tonë dhe bëhet pjesë e çdo lëvizjeje që ne bëjmë.

[57] "I njëjti burim",
[58] "Kelimatun Kisar", f. 65.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I PARË
POZITA E XHAMISË.....7
Xhamia është boshti i lëvizjes islame…….....7
Cili konsiderohet fqinj i xhamisë?.....9
Simbolika e xhamisë.....13
Ç'është Xhamia?.....20
Çfarë nënkuptohet me "Shtëpia e Allahut"?.....22
KAPITULLI I DYTË
DETYRIMET TONA NDAJ XHAMISË.....26
Ndërtimi i xhamisë.....26
Mos i braktisni xhamitë!.....30
Frekuentimi i xhamive.....33
Respektimi i xhamive.....36
Shpërblimi i frekuentuesve të xhamisë te Allahu i Madhëruar.....46
KAPITULLI I TRETË
ROLI I XHAMISË NË FORMIMIN E INDIVIDIT.....47
Xhamia, formuese e brezave të rinj besimtarë.....47
Xhamia, kështjella e fortifikuar e përpjekjes (xhihadit).....50
KAPITULLI I KATËRT
ROLI I XHAMISË NË SHOQËRI.....54
Roli shoqëror.....57

Roli përcjellës dhe transmetues.....59
Roli politik.....62
Roli luftarak.....65
Përfundimi.....67
Mbrojini xhamitë.....67

المسجد في فكر الإمام خميني

تيرانا 2018

اسم الكتاب: **المسجد في فكر الإمام خمينى**

المترجم: **الحاج ولنت مريا**

التدقيق: **صبريه فزا**

التصحيح الأدبي: **يريدا كولا**

التصحيح اللغوي: **ويولسا كاراي**

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: **صبريه فزا**

ناشر: **جمعية النسيم – تيرانا – ألبانيا**